



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10 Mars 2023

Nr: 160

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË INSTITUCIONIT TË
PRESIDENCËS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 10 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Llambriola Misto, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Institucionit të Presidencës

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të Institucionit të Presidencës, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 21.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e Institucionit të Presidencës.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 10 Mars 2023

Nr: 160
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Institucionit të Presidencës, për raportimin e veprimtarive publike”

“Presidenti Begaj vendos kurorë në Memorialin “Skënderbe”.

Link:

<https://president.al/presidenti-begaj-vendos-kurore-ne-memorialin-skenderbe/>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator dhe është trasmetuar në 1 (një) media publike.”

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 6.3.2023, Institucionit të Presidencës i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Institucioni i Presidencës bën me dije se: *“Në përgjigje të emailit tuaj lidhur me aktivitetin e Ceremonisë Përkujtimore në 555 Vjetorin e Vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti – Skenderbeu, Institucioni i Presidentit ka marr pjesë si pjesëmarrës dhe jo si organizator në ceremoninë Përkujtimore. Bashkëlidhur ju dërgojmë ftesën nga Bashkia Lezhë”.*

Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se Institucioni i Presidencës nuk është organizator i aktivitetit të sipërpërmendur, për pasojë në referim të legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportimin e aktivitetit është mbi institucionin organizator.

Ky detyrim është për institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Data: 10 Mars 2023 Nr: 160
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Institucionit të Presidencës, për raportimin e veprimtarive publike”

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Llambriola Misto, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Institucionit të Presidencës.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 10 Mars 2023 Nr: 160
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Institucionit të Presidencës , për raportimin e veprimtarive publike”